



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KRYEMINISTRIA**  
**MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR**

Nr. 3630/2 prot.

Tiranë, më 02.09.2024

**Lënda:** Kthim përgjigje për bashkëpunim në procesin e përmbushjes së synimeve të Rezolutës së Kuvendit “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

**Drejtuar:**

**Z.FATMIR XHAFAJ**  
**KRYETAR**  
**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

I nderuar z.Xhafaj,

Në përgjigje të shkresës nr.2583 prot., datë 28.06.2024 për bashkëpunim në procesin e përmbushjes së synimeve të Rezolutës së Kuvendit “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor do të kontribuojë nëpërmjet pjesëmarrjes të:

- 1) z. Ermal Elezi, Drejtori i Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore
- 2) z. Aldo Merkoci, këshilltar pranë Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.

Në funksion të realizimit të objektit të punës të Komisionit, shprehim gjithashtu gadishmërinë për të vënë në dispozicion të dhëna, raporte apo dokumente të tjera që lidhen me pushtetin vendor, si dhe të japim çdo kontribut tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga Komisioni.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**MINISTËR I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR**  
**Arbjan MAZNIKU**

